



**REPUBLIKA E K.S**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG**

---

Numri i lëndës: 2021:232298

Datë: 20.01.2022

Numri i dokumentit: 02625374

**PPP.nr.43/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA NË ISTOG**, si përmbartimore, me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike të kreditorit: R.. B... K., me nr te biznesit ... Rr. R.. D... nr. P., kundër debitorëve: V.H me nr personal ..., me adresë në Fsh R. K-Istog (kredi marrës) dhe A.G me nr personal ... me adresë në Fsh. R. K-Istog (Garantues), për shkak të borxhit në shumë prej 15,087.80 €, pas prapësimit të ushtruar nga ana e debitorit të parë V.H me dt.14.09.2021, kundër urdhrit mbi lejimin e përmbartimit, gjykata jashtë seance me dt.20.01.2022 nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.APROVOHET PJESËRISHT** prapësimi i debitorit të parë V.H nga Fsh R. K-Istog, ashtu që;

**II.SHFUQIZOHET PJESËRISHT** Urdhri mbi Lejimin e Përmbartimit P.nr.311/2021 të dt.06.09.2021, sa i përket sendeve të listuar në listën e pengut dhe atë Stufë për ngrohje, TV, Fshesë elektrike, Frigorifer, Stufë, Rrobalarëse, Enëlarëse dhe Mobile tjera pasi që janë sende që shërbejnë për përmbushjen e nevojave elementare dhe janë të përjashtuara nga përmbartimi.

**III.OBLIGOHET** debitori i parë V.H me nr personal ..., me adresë në Fsh R. K-Istog, që kreditorit R.. B... K., me nr te biznesit ... Rr. R.. D... nr. P., në emër të borxhit sipas marrëveshjes mbi kredi personale nr., t'ia paguaje shumën e përgjithshme prej 15,087.80 €, të gjitha këto me kamat ligjore prej 8 % nga dita e nxjerrjes se këtij aktvendimi e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Kreditori R.. B... K., me nr te biznesit ... Rr. R.. D... nr. P., ka ushtruar propozimin për përmbarim te përmbaruesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbarimi ndaj debitorëve V.H me nr personal ..., me adres në Fsh R. K-Istog (kredi marrës) dhe A.G me nr personal ... me adresë në Fsh. R. K-Istog (Garantues), si në shkresat e lëndës me të cilën do të paguajnë borxhin në shumë prej 15,087.80 €, me kamat ligjore dhe kamat ligjore te rregullt dhe kamatëvones, të gjitha këto ne afat 7 ditor nga dita e pranimit te urdhrin, ne të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare, sekuestrimimi i sendeve te lëna peng sipas listës se pengut dhe t'i dorëzohen kreditorit për shitje, që të realizoj kërkesën e tij ndaj debitorëve, të gjitha këto të specifikuar ne propozimin për përmbarim te dt. 03.09.2021.

Përmbaruesi privat me urdhrin përmbarimit P.nr.311/2021 të dt.06.09.2021, e ka lejuar propozimin për përmbarim në këtë çështje përmbarimore.

Debitori i parë V.H me nr personal ..., me adresë në Fsh R. K-Istog (kredi marrës), brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me shkrim kundër urdhrin përmbarimor, me te cilin ka kërkuar qe të aprovohet i njëjti si i bazuar dhe ti anuloj te gjitha veprimet përmbarimore me arsyetimin se dokumenti me te cilin është lejuar përmbarimi nuk i ka tiparet e përmbarueshmërisë ne kuptim te nenit 27 par.1, 36, 38 dhe 71 te LPP-së. Me tutje debitori i par ka shtuar se organi përmbarues ka kthej ne plotësim se propozimi për përmbarim është konfuz pasi qe marrëveshjen e kemi nënshkruar për 20,000 €, ndërsa ne petitum te propozimit e kërkon shumen prej 15,087.00 €.

Pas prapësimit të ngritur nga debitori i parë, kreditori ka paraqitur përgjigje në të njëjtin me kërkesë qe të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar me arsyetimin se i njëjti është i pa bazuar , ngase nuk është mbështetur ne nenin 69 par.4 si dhe nuk bazohet ne asnjë nga shkaqet e nenit 71 te LPP-së. Propozimi për përmbarim i plotëson te gjitha kushtet nga neni 38 dhe 22 par.1.7 e ne lidhje me nenin 21 te ligjit për regjistrim te pengut. Me tutje kreditori ka shtuar se ne bazë te nenit 305 par.1 dhe 2 te LMD-së përcaktohet se debitori është ne vonesë kur nuk e përmbush detyrimin brenda afatit te caktuar, andaj konsiderojmë se prapësimi i debitorit është i pa arsyeshëm dhe ka për qellim ta zvarritur procedurën.

Gjykata Themelore në Peje- Dega ne Istog, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit te parë dhe thëniet e cekura në të njëjtin dhe gjeti se i njëjti është i bazuar pjesërisht. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit tregojnë pjesërisht shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohej përmbarimi i lejuar nga përmbaruesi privat.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës, si dhe sa i përket pretendimeve të debitorit te parë ne prapësim kur thirren ne atë se dokumenti me te cilin është lejuar përmbarimi nuk i ka tiparet e përmbarueshmërisë ne kuptim te nenit 27 par.1, 36, 38 dhe 71 te LPP-së, te njëjtat pretendime persisht i aprovoj si te bazuara pasi qe dokumenti me te cilin është lejua përmbarimi konkretisht kontrata mbi kredinë personale nr. ma konkretisht shtojca nr.1 marrëveshja

mbi pengun, nga e cila ka rrjedh pastaj lista e pengut nr., konkretisht sendet e lana peng dhe atë Stufë për ngrohje, TV, Fshesë elektrike, Frigorifer, Stufë, Rrobalarëse, Enëlarëse dhe Mobile tjera, duke u bazuar ne nenin 85 par.1 te LPP-së i cili nen flet për sendet qe janë te përjashtuar nga përmbarimi, par.1.1 i po te njëjtit nen ne mënyrë specifike përcakton sendet qe përjashtohen prej përmbarimi dhe atë “ veshjet, këpucët, ndërresat dhe gjësendet tjera personale, çarçafët, veglat e kuzhinës, orenditë, stufa, frigoriferi dhe objektet tjera me vlerë të zakonshme që shërbejnë për përmbushjen e nevojave themelore të familjes, nëse janë të nevojshme nga debitori dhe familjarët e tij”, kurse neni 71 flet për bazën ku mund te mbështetet prapësimi, ku nder te tjetra par.1.5 i LPP-së parasheh se “përmbarimi është caktuar për sendet të cilat janë të përjashtuara nga përmbarimi i detyrueshëm dhe, si rezultat i këtij përjashtimi, mundësit për kryerjen e përmbarimit janë të kufizuara”, e ne rastin konkret duke u bazuar ne dispozitat e lartcekura gjykata vendosi si ne pikën I dhe II te dispozitivit te këtij aktvendimi duke e shfuqizuar pjesërisht urdhrin mbi lejimin e përmbarimit sa i përket sendeve qe janë te përjashtuara prej përmbarimit, pasi qe urdhri i tillë për atë pjesë është i pa lejuar dhe i pa përshtatshëm për përmbarim.

Kurse sa i përket pretendimeve te debitorit te parë lidhur me atë se propozimi për përmbarim është konfuz pasi qe marrëveshjen e kemi nënshkruar për 20,000 €, ndërsa ne petitum te propozimit e kërkon shumen prej 15,087.00 €, lidhur me pretendimet e lartcekura gjykata sqaron faktin se me rastin e nënshkrimit marrëveshjes mbi kredi personale nr. te dt. 14.06.2016, në vlerë prej 20,000 €, mirëpo pasi qe janë bërë disa pagesa borxhi është zbritur dhe për pagës ka mbet shuma prej 15,087.80 €.

Kujtojmë faktin se me rastin e nënshkrimit te Marrëveshjes mbi kredi personale nr. te dt. 14.06.2016, me te cilën marrëveshje kreditori i ka ofruar kredinë debitorit në vlerë prej 20,000 €, kurse debitori i parë ka qenë i obliguar qe te njëjtën shumë te të hollave ta kthej ne afat prej 120 muajve, ku 4, 5 dhe 6 janë paraparë kushtet e kthimit te kredisë, sigurimi i te njëjtës dhe detyrimet e përgjithshme te kredi marrësit dhe garantuesit, kurse ne nenin 7 dhe 8 te se njëjtës marrëveshje është paraparë qe ne rast mos përmbushjes se kredisë parashihen te drejtat dhe kompensimet nga ana e debitorit, andaj me rastin e shkeljes se neneve te kontratës, e cila kontratë është ligj për palët, janë shkaktuar pasoja juridike në dëm te kreditorit andaj dhe kërkon shumën si në propozim për përmbarim, e që debitori është i obliguar qe ta kthej këtë shumë si në pikën III te dispozitivit te këtij aktvendimi.

Se debitori i obligohet kreditorit shumën si në propozim për përmbarim, këtë fakt gjykata e mbështet ne nenin 245 te LMD-së ku par.1 parasheh se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, ndërsa par.2 i po te njëjtit nen parasheh se “Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak”.

Gjithashtu neni 249 par.1 te LMD-së parasheh se “Kreditori ka të drejtë në shpërblim të dëmit të thjeshtë dhe të fitimit të humbur, të cilat debitori është dashur t`i parashikonte detyrimisht në kohën e lidhjes së kontratës, si pasoja të mundshme të shkeljes së kontratës e duke marrë parasysh faktet të cilat i ka pasur të njohura ose është dashur detyrimisht t`i kishte të njohura”, ndërsa par.2 i po te njëjtit nen parasheh se “Në rast mashtrimi ose të mos përmbushjes me dashje, si dhe të mos përmbushjes për shkak të pakujdesisë së rëndë, kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitorët shpërblimin e të tërë dëmit, i cili është shkaktuar për shkak të shkeljes së kontratës, pa marrë parasysh atë se kreditori nuk ka ditur për rrethana të veçanta, për shkak të cilave janë shkaktuar ato”.

Lidhur me kamatën e aplikuar gjykata u bazua ne nenin 382 par.1 dhe 2 te LMD-së

Gjykata, duke u bazuar në nenin 17 të LPP-së, përshtatshmërisht aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, e konform dispozitave të nenit 3, 17, 22 par. 1.9, 36, 38, 69, 71 par.1.5, 73 par. 3 dhe 85 par.1 nen par 1.1 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, e në lidhje me nenin 245 par.1 dhe 2, 249 par. 1 dhe 2, dhe neni 382 par. 1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e në lidhje me nenin 4, 5, 6, 7, 8 dhe shtojcën 1 te Marrëveshjes mbi kredi personale nr. te dt. 14.06.2016 dhe Listën e pengut te dt. 09.06.2016, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG**  
**PPP.nr.43/2021, dt.20.01.2022**

**GJYQTARI**  
Blerim Istrefi

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.